



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 49

Qershor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.21, datë 13.1.2006	Për caktimin e administratorit të pavarur në shoqërinë “Vefa” në administrim.....	3
Vendim i KM nr.42, datë 13.1.2006	Për miratimin e planit të gjashtë të masave për sektorin e energjisë elektrike për vitet 2006-2008.....	3
Vendim i KM nr.45, datë 27.1.2006	Për miratimin e protokollit, në zbatim të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për bashkëpunimin policor.....	3
Vendim i KM nr.46, datë 27.1.2006	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Kompanisë Teatrorë Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar).....	6
Vendim i KM nr.49, datë 27.1.2006	Për miratimin e strukturës, organizimin, varësinë strukturore dhe limitin organik të Gardës së Republikës së Shqipërisë.....	7
Vendim i KM nr.65, datë 9.2.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për dhënie ndihme financiare familjes së zotit Fran Ndue Kaçorri, ish-polic i vrarë në krye të detyrës....	9
Vendim i KM nr.66, datë 9.2.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për dhënie ndihme financiare familjes së zotit Nikoll Ndue Gjikota, polic i plagosur në krye të detyrës..	9
Vendim i KM nr.67, datë 9.2.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, për përzgjedhjen e shoqërisë, që do të bëjë kontrollin e procedurave dhe të ligjshmërisë së kontratës për privatizimin e “Albtelecom” sh.a.....	10

Vendim i KM nr.75, datë 8.2.2006	Për miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, nënshkruar në Pragë, më 27 qershor 1994.....	10
Vendim i KM nr.128, datë 2.3.2006	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2006.....	12
Vendim i KM nr.130, datë 7.3.2006	Për revokimin e vendimit nr.46, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri kombëtar)”	12
Vendim i KM nr.150, datë 15.3.2006	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për bashkëpunim të ndërsjellë në çështjet doganore	13

VENDIM
Nr.21, datë 13.1.2006

**PËR CAKTIMIN E ADMINISTRATORIT TË PAVARUR NË SHOQËRINË “VEFA”
NË ADMINISTRIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7/1 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Astrit Qerimi caktohet në detyrën e administratorit të pavarur në shoqërinë “Vefa” në administrim.
2. Ngarkohet grupi mbikëqyrës dhe ish-administratorët e shoqërisë “Vefa” në administrim për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.42, datë 31.1.2006

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË GJASHTË TË MASAVE PËR SEKTORIN E ENERGISË
ELEKTRIKE PËR VITET 2006-2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të gjashtë të masave për sektorin e energjisë elektrike, për vitet 2006-2008, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr.28, datë 13.1.2005 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të pestë të masave për sektorin e energjisë elektrike për vitet 2005-2007, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.45, datë 27.1.2006

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT, NË ZBATIM TË MEMORANDUMIT TË
MIRËKUPTIMIT, NDËRMMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOZHME TË KOMBEVE
TË BASHKUARA NË KOSOVË PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit, në zbatim të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për bashkëpunimin policor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLL

NË ZBATIM TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, duke vepruar përmes Ministrisë së Brendshme, dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), duke vepruar përmes Shtyllës për Policinë e Drejtësinë, më poshtë të quajtura “Palë”;

duke marrë në konsideratë Memorandumin e Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin policor midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i datës 9 shtator 2002;

të bindur se bashkëpunimi ndërkombëtar është absolutisht i domosdoshëm për një parandalim të efektshëm të luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të drogave dhe lëndëve psikotrope, trafikimit të qenieve njerëzore dhe pastrimit të parave;

të vetëdijshëm se krimi i organizuar, terrorizmi, trafikimi i drogave dhe lëndëve psikotrope, trafikimi i qenieve njerëzore dhe pastrimi i parave përbëjnë një kërcënim serioz për zhvillimin e rregullt ekonomik-social dhe për mirëqenien e shtetasve të tyre;

të vetëdijshëm se organizatat kriminale, që veprojnë në nivel ndërkombëtar po përfshihen akoma edhe më shumë në aktivitetet e tyre të paligjshme të trafikimit;

duke pasur parasysh nevojën për të forcuar bashkëpunimin dypalësh në luftën kundër krimit në të gjitha format e tij, dhe duke besuar se një bashkëpunim i tillë duhet të jetë pjesë e veprimtarive të zakonshme institucionale për secilën nga administratat kompetente të të dy palëve.

kanë rënë dakors si më poshtë:

I

Krijimi i nënkomisioneve të përbashkëta

Nënkomisioni i përbashkët i Republikës së Shqipërisë dhe UNMIK-ut për sigurinë dhe operacionet (më poshtë i quajtur “Nënkomisioni i përbashkët 1”) dhe nënkomisioni i përbashkët për krimin dhe informacionin (më poshtë i quajtur “Nënkomisioni i përbashkët 2”) krijohen në kaudër të këtij protokollit.

II

Qëllimi i nënkomisioneve të përbashkëta

Qëllimi i nënkomisionit të përbashkët 1 është:

1. Çështjet e kufirit. Të rrisë koordinimin dhe bashkëpunimin në këtë fushë, në veçanti në fushat e kalimeve të paligjshme, kontrabandës së mallrave dhe kapjen e armëve. Të lehtësojë shkëmbimin e përbashkët të të dhënave në lidhje me trafikimin, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në juridiksionin e palëve.

2. Çështjet e sigurisë. Të lehtësojë shkëmbimin e përbashkët të informacionit në lidhje me çështjet ku përfshihet siguria publike, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në juridiksionin e palëve.

3. Çështjet e qarkullimit rrugor. Të lehtësojë shkëmbimin e përbashkët të informacionit në lidhje me çështjet ku përfshihet siguria në rrugë, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në juridiksionin e palëve.

4. Zhvillimet policore. Të njoftojë mbi progresin e zhvillimeve në shërbimet respektive policore, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në juridiksionin e palëve.

5. Dokumentet e udhëtimit dhe personale. Të kryejë njoftime reciproke mbi ndryshimet në formë ose në procedurë për lëshimin e dokumenteve personale dhe të udhëtimit, duke përfshirë kartat e identitetit, pasaportat, dokumente të tjera udhëtimi dhe patentat për drejtim automjetesh, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në juridiksionin e palëve.

Qëllimi i nënkomisionit të përbashkët 2 do të jetë:

1. Të rrisë koordinimin dhe bashkëpunimin në luftë kundër krimit dhe organizatave kriminale, veçanërisht në fushat e trafikimit të drogave dhe qenieve njerëzore, prostitucionit, pastrimit të parave dhe kontrabandës së armëve, përfshirë shkëmbimin e informacionit në lidhje me kriminelët dhe organizatat kriminale me qëllim forcimin e sigurisë rajonale dhe të përpjekjeve të rritjes së besimit, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në juridiksionin e palëve.

2. Të bashkëpunojë me qëllim luftën kundër terrorizmit, i cili destabilizon sigurinë rajonale dhe përpjekjet për rritjen e besimit, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në juridiksionin e palëve.

III

Takimet e nënkomisioneve të përbashkëta

1. Secila palë emëron një bashkëkryetar të nënkomisioneve të përbashkëta i cili kryeson delegacionin e asaj pale në çdo takim të nënkomisioneve të përbashkëta, i mbështetur nga një asistent bashkëkryetar.

2. Secili bashkëkryetar mund të asistohet në takimet e nënkomisioneve të përbashkëta nga ekspertët përkatës, ashtu si mund të gjykohet e arsyeshme në lidhje me çështjet që do të diskutohen në takim.

3. Përpilohet një rend dite i cili përbëhet nga katër pjesë:

- Çështje nga takimi i mëparshëm;
- Çështje të Policisë së shtetit shqiptar
- Çështje të UNMIK (policisë dhe drejtësisë)
- Çështje aktuale.

4. Për takimet e nënkomisionit të përbashkët 1, procesverbali mbahet nga pala pritëse për secilin takim. Një projekt-procesverbal i sigurohet nga pala pritëse palës tjetër për komente. Procesverbali përpilohet me aprovimin e të dyja palëve.

5. Për takimet e nënkomisionit të përbashkët 2, procesverbali mbahet nga pala pritëse në çdo takim. Në takimet ku përfshihen çështje delikate, të dyja palët mund të bien dakord që të mos mbahet procesverbal në lidhje me disa ose të gjitha çështjet delikate të diskutuara. Një projekt-procesverbal sigurohet nga pala pritëse për palën tjetër për komente. Procesverbali përpilohet me aprovimin e të dyja palëve.

6. Nënkomisionet e përbashkëta, në parim, mbledhen çdo dy muaj. Në fund të çdo takimi bihet dakord për datën e takimit të ardhshëm. Secila palë mund të kërkojë përpara kohe temat për takimin e ardhshëm, të cilat, nëse bihet dakord, vendosen në rendin e ditës.

7. Takimet e nënkomisioneve të përbashkëta mbahen në Tiranë, në Prishtinë ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të bihet dakord nga të dy bashkëkryetarët. Vendi i takimit ndryshon, me vendim të secilës palë.

8. Çdo takim drejtohet nga bashkëkryetari i palës pritëse. Pala pritëse siguron, të paktën 15 ditë përpara takimit, një kopje në shqip dhe në anglisht të rendit të ditës së termave që do të diskutohen.

9. Secila palë i siguron palës tjetër, të paktën 15 ditë përpara takimit, një kopje në shqip dhe në anglisht të çdo dokumenti të përgatitur nga ajo palë për t'u diskutuar në takim.

10. Secila palë, në përputhje me procedurat e krijuara, siguron për palën tjetër, të paktën 10 ditë përpara çdo takimi, emrat e anëtarëve të delegacionit të asaj pale.

11. Palët koordinojnë me anë të telefonit dhe me postë elektronike, të paktën 48 orë përpara secilit takim, me qëllim konfirmimin e vendit, orës dhe ndonjë detaji tjetër.

12. Përveç takimeve që zhvillohen çdo dy muaj, me kërkesë të njëjës palë, mund të organizohen edhe takime të tjera.

IV

Komunikimi

Secila palë cakton një person kontakti për autoritetet policore të asaj pale, i cili do të jetë i autorizuar për të marrë dhe për të siguruar informacion për të dorëzuar dhe për të marrë kërkesat për bashkëpunimin dhe për t'u ndërlidhur me personin kontaktues të palës tjetër në lidhje me të gjitha çështjet operacionale që hyjnë brenda fushës së këtij protokoll.

V

Ndryshimet

Ky protokoll mund të ndryshohet vetëm me anë të marrëveshjes me shkrim të palëve.

VI

Zgjidhja e konflikteve

Çdo konflikt ose mosmarrëveshje ndërmjet palëve, përsa i përket interpretimit ose zbatimit të këtij protokoll, zgjidhet në frymën miqësore nëpërmjet negociatave që do të zhvillohen në mirëbesim ndërmjet palëve

VII

Hyrja në fuqi

Ky protokoll do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit dhe me njoftimin nga palët për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të palëve për hyrjen e tij në fuqi.

VIII

Interpretimi

Ky protokoll firmoset në dy kopje origjinale në shqip dhe në anglisht, të dyja njëloj të barasvlershme. Në rast mospërputhjesh ndërmjet tekstit në gjuhën shqipe e atij në gjuhën angleze, merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

Të poshtëshënuarit, duke qenë dëshmitarë të autorizuar, në emër të palëve, kanë nënshkruar këtë protokoll.

VENDIM

Nr.46, datë 27.1.2006

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË KOMPANISË TEATRORE SHTETËRORE TË ARTIT DRAMATIK (TEATRI KOMBËTAR)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8578, datë 10.2.2000 "Për teatrin", me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Kiço Londo, drejtor i Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar), lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Ndriçim Xhepa emërohet drejtor i Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar).
3. Ngarkohet Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr.49, datë 27.1.2006


**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIZIMIN, VARËSINË STRUKTURE DHE
LIMITIN ORGANIK TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2005 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Gardës së Republikës së Shqipërisë të jetë sipas skemës nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Organika e Gardës së Republikës së Shqipërisë të jetë sipas skemës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Numri limit i punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë të jetë gjithsej, 1 056 veta.
4. Vendimi nr.557, datë 3.8.2005 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, organizimin, varësinë strukturore dhe limitin organik të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar shfuqizohet.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Brendshme.
6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



49

VENDIM
Nr.65, datë 9.2.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E BRENDSHME, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË ZOTIT FRAN
NDUE KAÇORRI, ISH-POLIC I VRARË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, për dhënie ndihme financiare familjes së z. Fran Ndue Kaçorri, ish-polic në komisariatit e policisë, Mirditë, i vrarë në krye të detyrës.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.66, datë 9.2.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E BRENDSHME, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË ZOTIT NIKOLL
NDUE GJIKOLA, POLIC I PLAGOSUR NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për dhënie ndihme financiare familjes së z. Nikoll Ndue Gjikota, polic në komisariatit e policisë, Mirditë, i plagosur në krye të detyrës.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.67, datë 9.2.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, PËR PËRZGJEDHJEN E
SHOQËRISË, QË DO TË BËJË KONTROLLIN E PROCEDURAVE DHE TË
LIGJSHMËRISË SË KONTRATËS PËR PRIVATIZIMIN E “ALBTELECOM” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh për përzgjedhjen e shoqërisë, që do të bëjë kontrollin e procedurave dhe të ligjshmërisë së kontratës për privatizimin e “Albtelecom” sh.a., si fond i ndarë si më poshtë vijon:

a) 62 500 000 (gjashtëdhjetë e dy milionë e pesëqind mijë) lekë për përzgjedhjen e shoqërisë, që do të bëjë kontrollin e procedurave dhe të ligjshmërisë së kontratës për privatizimin e “Albtelecom” sh.a.;

b) 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë për financimin e shpenzimeve të publikimit të procedurave të prokurimit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.75, datë 8.2.2006

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE, PËR NXITJEN DHE
MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE, NËNSHKRUAR NË PRAGË, MË 27
QERSHOR 1994**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e disa ndryshimeve, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi, në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, nënshkruar në Pragë, më 27 qershor 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCË

Neni 3

Trajtimi kombëtar dhe i kombit më të favorizuar

Ministria e Financës së Republikës së Çekisë propozon heqjen e paragrafit 3, neni 3 i marrëveshjes dhe zëvendësimin e tij me paragrafët nga 3 në 5:

3. Dispozitat për trajtimin kombëtar dhe atë të kombit më të favorizuar në këtë nen nuk do të jenë të vlefshme për përfitimet e dhëna nga pala kontraktuese në përputhje me detyrimin e saj si anëtare e bashkimit doganor, ekonomik ose monetar, e një tregu të përbashkët ose e një zone të tregtisë së lirë.

4. Pala kontraktuese njeh detyrimet e palës tjetër kontraktuese si anëtare e bashkimit doganor, ekonomik dhe monetar, e një tregu të përbashkët ose e një zone të tregtisë së lirë, për përfshirjen e detyrimeve që rrjedhin nga një marrëveshje ndërkombëtare ose e anasjellë e atij bashkimi doganor, ekonomik e monetar, tregu të përbashkët ose një zone të tregtisë së lirë.

5. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk do të interpretohen mënyrë të tillë që të detyrojnë një palë kontraktuese, të shtrihet deri tek investitorët e palës tjetër kontraktuese ose tek investimet, të ardhurat e investitorëve të tjerë, përfitimet nga çdo trajtim, preferencë ose privilegj, të cilat mund të zbatohen nga pala kontraktuese duke u mbështetur në cilëndo marrëveshje ndërkombëtare që lidhet plotësisht ose kryesisht me taksat.

Neni 6

Transfertat

Në përputhje me nenet 57.2, 59, 60.1 dhe 60.2 të Traktatit të formimit të Komunitetit Europian, Ministria e Financës së Republikës së Çekisë propozon përfshirjen e tekstit të mëposhtëm, lidhur me transfertat e pagesave të investitorëve ndaj një vendi të huaj, në fillimin e fjalisë së parë të paragrafit 1, neni 6 i Marrëveshjes:

“Pa cenuar masat e miratuara nga Komuniteti Europian ose ato të marra nga pala kontraktuese për arsye të rëndësishme politike dhe në raste emergjente...”.

Neni 11

Interesat bazë të sigurisë

Në përputhje me nenet 60 dhe 301 të traktatit të formimit të Komunitetit Europian, Ministria e Financës së Republikës së Çekisë propozon që pas nenit 10 të përfshihet-zbatimi i normave dhe angazhimeve të tjera të veçanta, neni 11- interesat bazë të sigurisë.

“Asgjë e përcaktuar në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet në mënyrë të tillë që të pengojë ndonjërin prej palëve kontraktuese për marrjen e masave, të cilat konsiderohen si të nevojshme për mbrojtjen e interesave bazë të sigurisë:

a) në lidhje me veprat penale;

b) në lidhje me trafikun e armëve, municioneve dhe mjeteve të luftës, si dhe marrëveshjet për mallrat, materialet, shërbimet dhe teknologjinë e ndërmarrë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, me qëllim furnizimin e njësisë ushtarake ose të sigurisë;

c) të ndërmarrja në kohë lufte ose gjendje të jashtëzakonshme në marrëdhëniet ndërkombëtare; ose

d) në lidhje me zbatimin e politikave kombëtare ose marrëveshjeve ndërkombëtare, duke respektuar mospërhapjen e armëve bërthamore ose mjeteve të tjera me shpërthim bërthamor; ose

e) në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Karta e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.”.

2. Interesat bazë të sigurisë të një pale kontraktuese mund të përfshijnë edhe interesat që vijnë si rrjedhojë e anëtarësisimit të saj në një bashkim doganor, ekonomik e monetar, në një treg të përbashkët ose një zonë të tregtisë të lirë.

Nenet pasuese të marrëveshjes do të rinumërohen.

VENDIM
Nr.128, datë 2.3.2006

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2006

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli i Ministrave në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh zëri “shpenzime korrente” për Agjencinë e Prokurimit Publik, nga të cilat 3 000 000 (tre milionë) lekë, në fondet e pakushtëzuara dhe 7 000 000 (shtatë milionë) lekë në fondet e kushtëzuara.

2. Ministrisë së Mbrojtjes në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i pakësohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh zëri “shpenzime korrente” nga të cilat 3 000 000 (tre milionë) lekë në fondet e pakushtëzuara dhe 2 000 000 (dy milionë) lekë në fondet e kushtëzuara.

3. Ministrisë së Brendëshme në buxhetin e miratuar për vitin 2006 t’i pakësohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh zëri “shpenzime korrente” në fondet e kushtëzuara.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, aparati i Këshillit të Ministrave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
NR.130, DATË 7.3.2006

PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR.46, DATË 27.1.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË
KOMPANISË TEATRORE SHTETËRORE TË ARTIT DRAMATIK (TEATRI
KOMBËTAR)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 124 të ligjit nr.8445, datë 12.5.1999 “Për procedurat administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Revokimin e vendimit nr.46, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.150, datë 15.3.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për bashkëpunim të ndërsjellë në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI PËR BASHKËPUNIMIN E NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi (në vijimësi referuar si “Palët kontraktuese”);

duke marrë parasysh që shkeljet e legjislacionit doganor janë të patolerueshme për interesat ekonomike, fiskale, tregtare, financiare, sociale dhe ato kulturore të vendeve respektive;

duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të përlllogaritjes dhe vjeljes së saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera në importin apo eksportin e mallrave, si dhe përcaktimin e saktë të vlerës dhe origjinës dhe luftës kundër trafikut të paligjshëm;

të shqetësuar për shkallëzimin dhe rritjen e tendencave të trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, duke i konsideruar ato një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

vlerësojnë nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në çështje lidhur me administrimin dhe forcimin e legjislacionit doganor.

të bindur se përpjekjet për të parandaluar shkeljet doganore do të jenë më efektive nëpërmjet bashkëpunimit të administratave doganore;

duke respektuar konventat në fuqi për bashkëpunimin e ndërsjellë si rekomandimet e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor për ndihmë të ndërsjellë administrative të 5 dhjetorit 1953, dhe rekomandimeve të tjera të Organizatës Botërore të Doganave,

ranë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje “Legjislacion doganor” do të thotë të gjitha ligjet apo aktet ligjore të përcaktuara me ligj të shteteve të “palëve kontraktuese” për importimin, eksportimin, tranzitimin e mallrave apo ndonjë procedurë tjetër doganore që lidhen me detyrimet doganore taksat dhe detyrime të tjera, ose me masat për ndalimin, kufizimin ose kontrollin, që zbatohen nga administrata doganore.

2. Detyrime doganore” do të thotë të gjitha detyrimet doganore dhe të gjitha taksat apo pagesat të cilat parashikohen të mblidhen me importimin apo eksportimin e mallrave, por pa përfshirë kuotat dhe detyrimet të cilat kufizohen në koston e përafërt të sasisë së shërbimeve të kryera.

3. “Autoritetet kërkues” do të thotë autoriteti doganor, i cili bënë kërkesë për asistencë në përpjekje me këtë marrëveshje ose autoriteti që merr asistencë të tillë.

4. “Autoriteti i kërkuar” do të thotë autoriteti doganor, i cili merr një kërkesë për asistencë në përpjekje me këtë marrëveshje ose i cili jep një asistencë të tillë.

5. “Kundërvajtjet doganore” do të thotë çdo shkelje e legjislacionit doganor, si edhe çdo përpjekje për shkelje të këtij legjislacioni.

6. “Autoritet doganor” do të thotë në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave , në Republikën e Malit të Zi-administrata doganore.

7 “Të dhëna personale” do të thotë çdo informacion për një person fizik të identifikuar apo person fizik që mund të identifikohet në shkelje apo përpjekje për të shkelur legjislacionin doganor;

8. “Droga narkotike”do të thotë çdo substancë natyrale apo sintetike e renditur në listën I dhe listën II të Konventës Unike të vitit 1961 të Drogave Narkotike.

9. “Substancat psikotrope” do të thotë çdo substancë natyrale apo sintetike apo çdo material natyral i renditur në listat I, II, III dhe IV të Konventës së substancave psikotrope të vitit 1971.

10. “Prekursor” do të thotë çdo substancë kimike e përdorur për qëllim prodhimin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope e renditur në listat I dhe II të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988 për luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope.

11 “Dërgesë e kontrolluar” nënkupton mënyrën e kalimit, importimit, eksportimit me dijeninë e autoriteteve doganore apo nën kontrollin e autoriteteve të këtyre vendeve të kalimit ilegal apo dyshemeve për kalimin ilegal të drogave narkotike, substancave psikotrope, prekursorëve apo substancave zëvendësuese të tyre me qëllim zbulimin e personave të përfshirë në këto shkelje doganore.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të ndihmojnë njëra-tjetrën mbi bazën e kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje për të siguruar zbatimin korrekt të legjislacionit doganor dhe në veçanti parandalimin, zbulimin, hetimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore, për të siguruar lehtësi dhe bashkëpunim në metodat doganore.

2. E gjithë asistencë dhe bashkëpunimi dhënë në përpjekje me marrëveshjen në fjalë do të jepet në përpjekje me legjislacionin kombëtar të shteteve të palëve kontraktuese.

Neni 3

Kërkesa për asistencë

1. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta furnizojë atë me të gjithë informacionin përkatës, në mënyrë që të mundësohet siguria që legjislacioni doganor është zbatuar korrektësisht, duke përfshirë *inter alia* informacion lidhur me transportin dhe ngarkesën e, vendndodhjen dhe destinacionin e mallrave, vlerën dhe origjinën, gjithashtu informacionin lidhur me veprime të kryera ose të planifikuara, të cilat bien ndesh ose mund të bien ndesh me këtë legjislacion.

2. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta informojë atë nëse mallrat e eksportuara nga territori doganor i shtetit të njëjës prej palëve kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin doganor të shtetit të palës tjetër kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e vet doganor, duke specifikuar nëse është e nevojshme, procedurat doganore dhe masat e kontrollit të aplikuara mbi këto mallra.

3. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta informojë atë nëse mallrat e importuara në territorin doganor të shtetit të njëjës prej palëve kontraktuese janë eksportuar posaçërisht nga territori doganor i shtetit të palës tjetër kontraktuese, në përputhje me legjislacionin doganor, duke specifikuar, nëse është e nevojshme, procedurat doganore dhe masat e kontrollit të aplikuara ndaj këtyre mallrave.

4. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar, brenda kompetencave dhe mundësive të veta do të ndër marrë hapat e nevojshme për të siguruar se po mbahen nën survejim:

a) persona të caktuar, për të cilët ka baza të shëndosha mbi të cilat besohet se ata kanë shkelur apo janë duke shkelur legjislacionin doganor në fuqi në territorin e autoritetit kërkues;

b) vende ku janë magazinuar mallra në mënyrë të tillë që të bën të dyshosh se ato janë parashikuar për t'u importuar në mënyrë të paligjshme në territorin e autoritetit kërkues;

c) lëvizjen e mallrave të njoftuara nga autoriteti kërkues si të tilla që mund të sjellin trafik thelbësor të paligjshëm për në, apo nga territori doganor i shtetit të autoritetit kërkues, apo dyshime mbi këtë;

d) mjetet e transportit, për të cilat ka baza të forta për të besuar se ato kanë qenë, janë ose do të përdoren për shkelje të legjislacionit doganor në territorin e shtetit të palëve kontraktues kërkuese.

Neni 4 Asistencë spontane

Autoritetet doganore të palëve kontraktuese, brenda kompetencave të tyre, do të furnizojnë njera-tjetrën me asistencë, të cilën ato e konsiderojnë të dobishme mbi zbatimin korrekt të legjislacionit doganor, veçanërisht kur ato kanë informacion lidhur me:

- akte të cilat kanë shkelur, shkelin ose do të përbëjnë shkelje të këtij legjislacioni dhe të cilat mund t'u interesojnë palës tjetër kontraktuese;

- mjete të reja ose metoda të përfshira në kryerjen e kundërvajtjeve të legjislacionit doganor;

- mallra të njohura apo të dyshuara që kanë qenë subjekt i shkeljeve doganore ndaj legjislacionit doganor në territorin e shtetit të palëve tjetër kontraktuese;

- persona të veçantë të njohur ose të dyshuar se kanë kundërvajtje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e shtetit të njëjës prej palëve kontraktuese;

- mjetet e transportit dhe kontenjerët, për të cilat ekziston informacion ose dyshime se kanë qenë përdorur, përdoren ose mund të përdoren për kryerjen e shkeljeve ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese.

Neni 5 Asistenca teknike

1. Asistenca, siç parashikohet në këtë marrëveshje, do të përfshijë *inter alia* informacion lidhur me:

a) aksione antikontabandë që mund të ndërmerren për parandalimin e shkeljeve;

b) metoda të reja aplikuar për kryerjen e shkeljeve;

c) observime dhe gjetje që rezultojnë nga aplikimi i sukseshëm i mjeteve dhe teknikave të reja të antikontabandës; dhe

d) teknika të reja dhe metoda të përmirësuara të përpunimit të ngarkesave dhe pasagjerëve.

2. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të kërkojnë gjithashtu kooperim, nëse kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e tyre kombëtar lidhur me:

a) inicimin, zhvillimin ose përmirësimin e programeve specifike të trajnimit për personelin e tyre;

b) krijimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të komunikimit ndërmjet tyre, me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të sigurt dhe të shpejtë të informacionit;

- c) lehtësimin e koordinimit efektiv ndërmjet tyre, duke përfshirë shkëmbimin e personelit, ekspertëve dhe vendosjen e punonjësve ndërlidhës;
- d) marrjen në konsideratë dhe testimin e pajisjeve ose procedurave të reja;
- f) thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave të tyre respektive doganore; dhe
- g) çdo çështje tjetër të përgjithshme administrative që mund të kërkojë aksione të përbashkëta.

Neni 6

Dërgesat/njoftimet

Duke u bazuar në kërkesën e autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar, në përputhje me legjislacionin, do të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim:

- a) dorëzimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm;
- b) njoftimin e të gjitha vendimeve të marra që bien brenda fushës së veprimit të kësaj marrëveshjeje, lidhur me një person rezident ose të vendosur në territorin e vet. Në këtë rast, do të aplikohet paragrafi 3 i nenit 7.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e kërkesës për asistencë

1. Kërkesat në zbatim të kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Dokumentet apo informacioni i nevojshëm për ekzekutimin e një kërkesë të tillë duhet të bashkëshoqërojnë kërkesën. Nëse kërkohet, për shkak të emergjencës së situatës, mund të pranohet kërkesë gojore, por duhet të konfirmohet me shkrim, maksimumi, brenda tre ditëve punë.

2. Kërkesat, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfshijnë informacionin e mposhtëm:

- a) autoritetin kërkues të cilit i bëhet kërkesa;
 - b) masat që nevojitet të merren;
 - c) objekti dhe arsyet për kërkesë.
 - d) ligjet, rregullat dhe elementet e tjera ligjore të përfshira;
 - e) treguesit sa më ekzaktë dhe të kuptueshëm të mundur mbi personat për të cilët bën fjalë kërkesa;
 - f) një përmbledhje të fakteve lidhur me çështjen, përveç rasteve të parashikuara në nenin 6 të kësaj marrëveshjeje; dhe
 - g) lidhjen mes asistencës së kërkuar dhe çështjes për të cilën bëhet fjalë.
- Kërkesa duhet të dërgohet në një gjuhë zyrtare të autoritetit doganor, në anglisht ose në një gjuhë të pranueshme prej atij autoriteti.

Asistenca do të kryhet nëpërmjet komunikimit direkt mes autoriteteve respektive doganore.

Në rastin kur autoritetet doganore të palës kontraktuese të kërkuar nuk janë agjencia kompetente për të përbushur kërkesën, ajo do ta transmetojë në mënyrë ekzakte kërkesën tek organet kompetente, të cilat do të veprojnë sipas kërkesës në përputhje me fuqitë e tyre sipas ligjit ose do të këshillojnë autoritetin kërkues mbi procedurat që duhen ndjekur lidhur me një kërkesë të tillë.

Nëse kërkesa nuk i përbush detyrimet formale, mund të kërkohet korrektimi ose kompletimi, gjithsesi mund të bëhet kërkesë për marrjen e masave paraprake.

Neni 8

Ekzekutimi i kërkesës

1. Autoriteti i kërkuar do të marrë të gjitha masat të cilat i gjykon të arsyeshme për të ekzekutuar kërkesën dhe nëse është e nevojshme, do të përpiqet të kërkojë çfarëdolloj mase ligjore apo zyrtare të duhur për realizimin e kërkesës.

2. Autoriteti doganor i një pale kontraktuese, sipas kërkesës së autoritetit doganor të palës tjetër kontraktuese, do të bashkërendojë çfarëdolloj investigimi të nevojshëm, duke përfshirë marrjen në pyetje të ekspertëve ose të dëshmitarëve, ose të personave të dyshuar se kanë kryer një shkelje, dhe do të ndërmarrë verifikime, inspektime dhe hetime për gjetje faktesh lidhur me çështjet e referuara në marrëveshjen në fjalë. Në këto investigime autoriteti i kërkuar i palës kontraktuese do të procedojë si të ishte duke vepruar për interes të vet. Rezultatet e këtij investigimi do t'u dërgohen autoriteteve kërkuese të palës kontraktuese.

3. Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar, në mundësitë e veta maksimale, do të lejojë nëpunësit e autoritetit kërkuar të jenë prezent në territorin e shtetit të kërkuar të palëve kontraktuese, ndërkohë që nëpunësit e vet janë duke kryer investigime mbi shkeljet që i interesojnë autoritetit kërkuar. Ata duhet të provojnë aftësitë e nëpunësve të tyre. Në këto raste, nëpunësit e palës kërkuese mund të marrin pjesë aktivisht në investigim.

4. Autoriteti kërkuar, nëse kërkon, do të informohet mbi kohën dhe vendin e aksioneve që do të ndërmerren në përgjigje të kërkesës së kryer, në mënyrë që aksionet të koordinohen.

5. Nëpunësit e autoritetit kërkuar, të autorizuar për të investiguar shkeljet, mund të kërkojnë që autoriteti i kërkuar të bëjë ekzaminimin e regjistrave, librave, dokumenteve, të dhënave mediatike të tjera dhe të furnizohen me çfarëdolloj informacioni lidhur me shkeljet doganore.

Neni 9

Forma me të cilën do të komunikohet informacioni

1. Autoriteti i kërkuar do t'i komunikojë rezultatet e arritura autoritetit kërkuar në formën e dokumenteve, kopjeve të noterizuara të dokumenteve, raporteve dhe të ngjashmeve me to dhe kur është e nevojshme, gojarisht.

2. Dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 mund të zëvendësohen nga informacioni kompjuterizuar, prodhuar në çdo formë për të njëjtin qëllim, do të shoqërohet bashkë me të çdo informacioni i nevojshëm për interpretimin dhe përdorimin e informacionit të kompjuterizuar.

Neni 10

Përjashtime nga detyrimi për të dhënë asistencë

1. Në rastet kur autoriteti i kërkuar është i mendimit se përgjigja ndaj një kërkesë për asistencë mund të bjerë ndesh me sovranitetin, sigurinë, politikat publike ose interesa të tjera themelore kombëtare, ose mund të shkelë sekrete profesionale, komerciale apo industriale, asistencë mund të refuzohet ose mund të përmbushet vetëm në bazë të respektimit të disa kushteve ose kërkesave. Asistencë gjithashtu mund të refuzohet nëse kërkesa përfshin rregulla (ligje) valutore ose tatimore të tjera nga ligjet mbi detyrimet doganore.

2. Kur autoriteti kërkuar kërkon asistencë, i cili vetë nuk mund ta përmbushë nëse i kërkohej diçka e tillë, kjo gjë duhet të theksohet në kërkesë. Në këtë rast varet nga autoriteti i kërkuar vendimi se si do t'i përgjigjet një kërkesë të tillë.

3. Nëse asistencë pezullohet apo mohohet, autoriteti kërkuar duhet të njoftohet pa vonesë lidhur me këtë vendim dhe mbi shkaqet që çuan aty.

Neni 11

Detyrimet e ruajtjes së konfidencialitetit

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme në përputhje me këtë marrëveshje, do të jetë i një natyre konfidenciale dhe do të gëzojë të njëjtën mbrojtje të zgjeruar nën ligjet përkatëse lidhur me një informacion të njëjtë me atë të aplikuar në palën kontraktuese që e merr atë.

2. Të dhënat personale mund të transmetohen vetëm nëse legjislativi i palëve kontraktuese është ekuivalent në lidhje me nivelin e ruajtjes së të dhënave personale. Palët kontraktuese duhet të sigurojnë një nivel mbrojtjeje të bazuar në principet e parashtruara në aneksin bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, e cila është pjesë përbërëse e saj.

Neni 12

Përdorimi i informacionit

1. Informacionet, dokumentet dhe komunikimet e tjera të marra në kursin e asistencës reciproke mund të përdoren vetëm për qëllimet e specifikuar në marrëveshjen në fjalë, duke përfshirë përdorimin në proceset gjyqësore dhe administrative.

2. Autoriteti kërkuar nuk do të përdorë evidencat ose informacionin e marrë nën këtë marrëveshje për qëllime të tjera veç atyre të përcaktuara në kërkesë, përpara marrjes së konsensusit me shkrim nga autoriteti i kërkuar.

3. Kur nën këtë marrëveshje janë shkëmbyer të dhëna personale, autoritetet doganore të palëve kontraktuese duhet të sigurojnë se këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në kërkesë dhe në përputhje me kushtëzimet që mund të imponojë pala e kërkuar.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen për informacionet që kanë të bëjnë me shkelje lidhur me drogat narkotike dhe substancat psikotrope. Informacione të tilla mund t'u komunikohen autoriteteve të shtetit të autoritetit kërkuar të cilat janë direkt të lidhura me luftën ndaj trafikut ilegal të drogës.

Neni 13

Lufta kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve

1. Autoritetet doganore të dy palëve do të ndihmojnë njëra-tjetrën në parandalimin dhe investigimin e trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, duke i siguruar njëra-tjetrës, mbi bazën e një kërkesë me iniciativën e vet, gjithë informacionin e nevojshëm mbi:

a) metodat e luftës së trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

b) principet e kontrollit doganor mbi drogat narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, metodat e reja dhe mënyrat e deduktimit;

c) publikimet profesionale dhe shkencore të kohëve më të fundit dhe ndihma në trajnim lidhur me luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

d) llojet e reja të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, vendi i prodhimit, rrugët e përdorura nga kontrabandistët dhe metodat e fshehjes, ndryshimet e çmimit të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve në vende dhe rajone të ndryshme.

2. Autoriteti doganor i njërit nga palët kontraktuese, me iniciativën e vet dhe në formë të dokumentuar, i ofron autoritetit doganor të palës tjetër kontraktuese gjithë informacionin lidhur me:

a) personat fizikë dhe juridikë, të njohur apo të dyshuar si pjesëmarrës në importimin, eksportimin apo trafikimin e paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

b) Metodat e reja dhe mënyrat e përdorura në trafikun e paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

c) Mallrat apo pakot postale të njohura apo të dyshuara si objekt i trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

d) Mjetet e transportit të njohura apo të dyshuara për t'u përdorur me qëllim trafikimi të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

Neni 14

Dërgesat e kontrolluara

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të bashkëpunojnë në implementimin e metodave për dërgesat e kontrolluara.

2. Vendimi mbi implementimin e metodave të dërgesave të kontrolluara do të merret në çdo rast konkret në përputhje me legjisllacionin në fuqi të shteteve të palëve kontraktuese.

Neni 15

Skedarët, dokumentet dhe dëshmitarët

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese, sipas kërkesës, do të japin dokumentacion lidhur me transportin e mallrave duke treguar vlerën, origjinën, vendndodhjen dhe destinacionin e këtyre mallrave.

2. Origjinalet e skedarëve, dokumenteve dhe materialeve të tjera do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet janë të pamjaftueshme. Në bazë kërkesë specifike, kopjet e këtyre dosjeve, dokumenteve dhe materialeve të tjera duhet të autentifikohen (noterizohen) saktësisht.

3. Origjinalet e dosjeve, dokumenteve dhe materialeve të tjera që kanë qenë dërguar tek autoriteti kërkues, duhet të kthehen me mundësinë si më parë. Të drejtat e autoritetit të kërkuar ose të palëve të treta lidhur me to, do të mbeten të paprekura. Sipas kërkesës së autoritetit të kërkuar, origjinalet e nevojshme për procedime ose qëllime të ngjashme duhet të kthehen pa vonesë.

4. Sipas kërkesës së autoritetit doganor të njëjës prej palëve kontraktuese, autoriteti doganor i palës tjetër kontraktuese do të autorizojë nëpunësit e vet (sipas përzgjedhjes së saj) nëse këta nëpunës pranojnë një gjë të tillë, të paraqiten si dëshmitarë në procese penale ose administrative në territorin e autoritetit kërkues, dhe të prodhojnë dokumente, dosje dhe materiale të tjera, ose kopje të autentifikuara të tyre, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për proceset. Një kërkesë e tillë duhet të specifikojë kohën, vendin dhe tipin e procesit, si dhe statusin nën të cilin ky nëpunës do të dëshmojë.

Neni 16

Shpenzimet

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të heqin dorë nga çdo kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve të dalta gjatë vënies në zbatim të marrëveshjes në fjalë, me përjashtim të shpenzimeve lidhur me dëshmitarët, ekspertët dhe shpenzimet për përkthyesit që nuk janë punonjës shtetërorë.

2. Nëse kërkohen ose do të kërkohen shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme lidhur me ekzekutimin e kërkesës, autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të konsultohen për përcaktimin e kushteve dhe termave nën të cilat do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mbi mënyrën e lindjes së këtyre shpenzimeve.

Neni 17

Zbatimi i marrëveshjes

1. Vënia në zbatim e kësaj marrëveshjeje do t'i ngarkohet autoriteteve doganore të palëve kontraktuese. Ato do të vendosin mbi rregullimet e nevojshme për zbatimin e marrëveshjes, duke respektuar rregullat në fushën e ruajtjes së të dhënave.

2. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese mbi bazë konsultimesh mund të paraqesin akte staturore të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes.

3. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese mund të përcaktojnë vetë për shërbimet e tyre investiguese, komunikimin e tyre të drejtpërdrejtë.

Neni 18

Zgjidhja e konflikteve

Të gjitha konfliktet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen përmes konsultimesh apo negociatash të palëve kontraktuese.

Neni 19

Procedura e ndryshimeve dhe përmirësimeve

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo përmirësohet nëpërmjet marrëveshjesh reciproke të palëve kontraktuese. Ndryshimet dhe përmirësimet do të legalizohen nga protokollet respektive, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e saj.

Neni 20

Shtrirja territoriale

Kjo marrëveshje do të zbatohet në territoret doganore të dy shteteve të palëve kontraktuese, si parashikohet në legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 21

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason muajin e marrjes së notës së fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me të cilat palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur të gjitha kërkesat e brendshme respektive ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

2. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese bien dakord të takohen deri në fund të pesë viteve me qëllim rishikimin e kësaj marrëveshjeje ose të diskutojnë probleme në fushën e doganave, të cilat mund të lindin gjatë këtij bashkëpunimi dhe, nëse nuk është e nevojshme, t'i zyrtarizojnë njëra-tjetrës me shkrim se rishikime të tilla nuk janë të nevojshme.

3. Kjo marrëveshje është menduar të jetë e pakufizuar në kohë, derisa njëra nga palët t'i japë fund me shkrim. Marrëveshja zgjidhet pas gjashtë muajve që kur pala tjetër merr njoftimin zyrtar nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Dëshmitarë për sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Tiranë më 23 dhjetor 2005, në dy kopje, secila në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast divergjence për shkak të interpretimit, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

ANEKS

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik:

- a) do të merren dhe përpunohen me ndershmëri dhe në mënyrë ligjore;
- b) do të ruhen për qëllime të caktuara dhe të ligjshme dhe nuk përdoren në ndonjë mënyrë që nuk përputhet me këtë qëllim;
- c) janë adekuate, me lidhje dhe jo ekstreme për qëllimet për të cilat janë ruajtur;
- d) të sakta, dhe kur është e nevojshme, të rinovuara;
- e) ruhen në formën që lejon identifikimin e të dhënave, me kusht për jo më gjatë sesa kërkohet për qëllimet për të cilat ruhen ato të dhëna.

2. Të dhënat personale që lidhen me origjinën raciale, bindjet politike, fetare, dhe të dhëna lidhur me shëndetin apo jetën seksuale, mund të mos përpunohen në mënyrë automatike nëse ligjet e brendshme nuk garantojnë sigurinë e duhur. E njëjta aplikohet edhe për të dhënat personale në lidhje me të dënuarit për krime.

3. Duhet të merren masat e duhura të sigurimit për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në skedaret e kompjuterizuar të të dhënave përkundrejt ndonjë shkatërrimi të paautorizuar apo humbje aksidentale, si dhe kundër futjes së paautorizuar tek ato, ndryshimit apo shpërndarjes së tyre.

4. Çdo person duhet të ketë mundësi:

a) të përcaktojë ekzistencën e një skedari të kompjuterizuar të të dhënave personale, qëllimet kryesore që ka ky skedar, si dhe identitetin dhe vendqëndrimin e rregullt apo vendndodhjen kryesore të kontrolluesit të këtij skedari;

b) të përfitojnë në intervale të arsyeshme dhe pa vonesa të tepruara apo shpenzime, konfirmimin nëse të dhënat personale që lidhen me të janë ruajtur në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave dhe se këto të dhëna i komunikohen atij në një formë të lexueshme;

c) të përfitojë, sipas rastit, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave të tilla nëse ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm dhe cenojnë parimet bazë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij aneksi;

d) t'i mundësohet mbështetje nëse një kërkesë për komunikim, ose komunikim sipas rastit, përshtatje, fshirje të dhënash si parashikohet në nënparagrafët b dhe c të këtij paragrafi nuk është e zbatueshme.

5.1 Nuk lejohet përjashtim nga pikat 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi, me përjashtim të rasteve brenda kufijve të përcaktuara në këtë paragraf.

2. Shmangia nga dispozitat e pikave 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi lejohet vetëm atëherë kur një shmangie e tillë parashikohet me ligj të palës kontraktuese dhe përbën një masë të domosdoshme për një shoqëri demokratike dhe është në interes:

a) të mbrojtjes së sigurisë shtetërore, qetësisë publike, interesave monetare të shtetit ose dënimin e shkeljeve kriminale ;

b) të mbrojtjes së thelbit të të dhënave të drejtave të lirisë së të tjerëve.

3. Kufizimi për ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në pikën 4, në nënparagrafët “b”, “c” dhe “d” të këtij aneksi mund të sigurohen me ligj në rastin e dosjeve të të dhënave personale të kompjuterizuara, të përdorura për qëllime statistikore apo për kërkime shkencore kur aty nuk ka asnjë rrezik të dukshëm për shkelje të privacisë së subjektit të dhënë.

Çdo palë kontraktuese merr përsipër përcaktimin e sanksioneve të duhura dhe përmirësimin e ligjit të brendshëm për shkeljen e dispozitave të cilat kanë efekt në principet bazë të përcaktuara në këtë aneks.

Asnjë nga dispozitat e këtij aneksi nuk do të interpretohet si kufizim apo ndikim mbi mundësitë e një pale kontraktuese për t'i dhënë subjektit të të dhënave një masë më të gjerë mbrojtjeje nga ajo që është përcaktuar në këtë aneks.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbraja ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë